



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

### ANALIZË VJETORE - 2014

Zbatimi i detyrave që dalin nga Plani Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE), i cili ka reflektuar detyrimet e DPS ndaj nenit 75 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, si dhe rekomandimet e raportit analitik të KE-së të vitit të kaluar ka qenë fokusi kryesor i punës sonë për këtë vit.

Bazuar në sa më sipër prioritetet tona në terma afatshkurtër dhe afatgjatë respektivisht janë:

- Progres i mëtjshëm në adoptimin e standardeve europiane dhe plotësimi i kriterëve për t'u bërë anëtar me të drejta të plota në CEN dhe CENELEC;
- Përmirësimi i funksionimit të DPS si Organi Kombëtar i Standardeve, duke aplikuar praktikat më të mira europiane;
- Rritja e ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë në lidhje me konceptet e standardeve dhe rëndësinë e përdorimit të tyre në produktet dhe shërbimet që ofrohen në tregun e brendshëm dhe në tregtinë rajonale e ndërkombëtare;
- Pjesëmarrja në punën Europiane e ndërkombëtare të standardizimit dhe trajnimi i stafit me praktikat dhe procedurat e punës së organizmave homologe.

#### Përafrimi i legjislacionit

Në kuadrin e përafrimit të legjislacionit tonë me atë të vendeve të BE-së dhe bazuar edhe nga sa parashikohet në PKIE,

#### Legjislacioni në fushën e Standardizimit është si më poshtë:

- Ligji nr. 9870, datë 04.02.2008 "Mbi Standardizimin" (Fletorja zyrtare nr.18, 19/02/2008);
- Ligji nr.10384, datë 24.02.2011 (Fletorja zyrtare nr. 25, 25/03/2011) "Mbi disa ndryshime në Ligjin mbi Standardizimin";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.789, datë 22.07.2009 "Për notifikimet në zbatim të Marrëveshjes së WTO/TBT dhe WTO/SPS";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.433, datë 5.5.2010 "Mbi krijimin, përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e Bordit Drejtues të DPS-së";
- Rregullore për përbërjen, funksionimin dhe kompetencat e Bordit Drejtues të DPS 12/11/2010;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.190, datë 13.3.2012 "Për Kodin e hartimit, adoptimit, miratimit dhe zbatimit të standardeve", i cili ngarkon DPS me detyrën e zbatimit të parashikimeve të dhëna në Aneksin 3 të Marrëveshjes së OBT mbi Barrierat Teknike në Tregti.

Gjithashtu, në përputhje me rregulloret e brendshme të CEN dhe CENELEC dhe ETSI janë miratuar rregulloret e brendshme të DPS-s, si:

- Udhëzues për Delegatët Shqiptarë që marrin pjesë në komitetet teknike të standardizimit në nivel evropian dhe ndërkombëtar;
- Rregullorja mbi veprimtarinë dhe funksionimin e Forumit Kombëtar të Standardizimit;
- Përbërja e Bordit Teknik dhe mënyra e funksionimit të tij;
- Notifikimet e standardeve kombëtare S SH EN në CEN dhe CENELEC;
- Procedura e Pezullimit (*Standstill*);
- Rregullat dhe Procedurat për Veprimtaritë Kombëtare të Standardizimit;
- Shpërndarja dhe Shitja e Standardeve;
- Rregullorja e Brendshme e DPS-së mbi adoptimin e standardeve të ETSI-it.

Projektligji i amenduar gjatë këtij viti është projektligji nr....., datë..... “Për disa ndryshime në Ligjin për Standardizimin”, i ndryshuar, i cili pritet të miratohet brenda 6 mujorit të dytë të 2015 dhe ka për qëllim përmirësimin e legjislacionit në fushën e standardizimit në drejtim të përputhjes së tij, specifikisht me ligjin 152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil” dhe me Rregulloren e BE-së nr.1025/2015 “Mbi Standardizimin Europian” sa i përket detyrimeve mbi notifikimet.

Gjithashtu, gjatë këtij viti është amenduar Vendimi nr.433/2010 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e Bordit Drejtues të DPS-së”.


Ndryshimet e propozuara në VKM 433/2010 kanë të bëjnë me rregullimin e emërtimeve të përfaqësuesve të ministrive dhe institucioneve përkatëse sipas fushës që ato mbulojnë dhe jo më me emra konkretë ministrish apo institucioneve respektive.

### Adoptimi i standardeve Europiane

Gjatë vitit 2014 kanë funksionuar 61 Komitete Teknike (KT) të cilët janë pasqyrë e KT-ve të CEN dhe CENELEC. Në këto KT për adoptimin e standardeve të planifikuara nga Bordi Teknik i DPS-së janë aktivizuar rreth 170 ekspertë, të cilët vijnë nga sektorët privat dhe shtetëror, institucione shkencore, administrata publike, etj. Janë mbajtur dy mbledhje të Bordit Teknik dhe rreth 200 mbledhje të Komiteteve Teknike.

Gjithsej janë adoptuar rreth 97% e totalit të standardeve EN të të dy organizmave evropiane të standardizimit, CEN dhe CENELEC. Për 2014 janë adoptuar **2435** standarde, **310** amendamente dhe **144** dokumenta standardizimi, nga të cilat **2105** janë standarde evropiane (**1069** janë standarde të CEN dhe **411** janë standarde të CENELEC dhe **625** janë standarde të ETSI) dhe **330** janë standarde ndërkombëtare (**199** janë standarde të ISO dhe **131** janë standarde të IEC).

Grafiku i mëposhtëm paraqet gjendjen aktuale të Standardeve Shqiptare dhe strukturën sipas llojeve:



| Lloji     | SSH  | SSH EN | SSH ISO+IEC | Të tjera | Totali |
|-----------|------|--------|-------------|----------|--------|
| Standarde | 3022 | 19161  | 3032        | 689      | 25904  |

Janë adoptuar 100% e standardeve Evropiane të harmonizuara si Standarde Shqiptare të harmonizuara. Adoptimi i standardeve është bërë me metodën me përkthim të faqes së parë. Numri i standardeve të përkthyer në shqip është shumë i vogël krahasuar me totalin e adoptimeve.

Gjatë 2014 janë shfuqizuar 1037 standarde evropiane të CEN&CENELEC, 53 standarde ndërkombëtare të ISO&IEC dhe 55 standarde Italiane të UNI. Gjithashtu, janë shfuqizuar 21 dokumenta standardizimi dhe 8 amendamente të shfuqizuara nga organizmat përkatëse. Gjatë kësaj periudhe janë shfuqizuar dhe 33 standarde puro Shqiptare (S SH).

## Faqja e internetit

Gjatë këtij viti DPS-ja ka ri-freskuar faqen e re të internetit [www.dps.gov.al](http://www.dps.gov.al), duke e bërë atë më transparente për qytetarët dhe çdo palë tjetër të interesuar. Në faqe janë pasqyruar informacionet më të fundit rreth aktivitetit të DPS-së, të tilla si:

- Mbledhjet e Bordit Drejtues (**21** Mars 2014 dhe **20** Qershor 2014);
- Mbledhjet e Bordit Teknik (**07** Shkurt 2014 dhe **04** Korrik 2014); si dhe

arritjet në fushën e standardizimit, duke përgatitur dhe publikuar në faqe mbi 15 artikuj e njoftime për shtyp, foto dhe pasqyrime të pjesëmarrjes në panairët, takimet kombëtare e ndërkombëtare të DPS-së.

Kështu, mund të përmendim publikimin në faqen e internetit të DPS-së **Artikujt**:

- “Kujdesi për robotët ka marrë dritën jeshile në 19 Shkurt 2014”;
- “Standardet ndihmojnë në rritjen e cilësisë së shërbimeve”;
- “Kontributi i standardeve ISO në ekzaminimin e suksesshëm të kancerit të gjirit”;
- “Mbi Sistemet e Menaxhimi të Energjisë”;
- “Zbuloni më tepër rreth Përgjegjësisë Sociale të Korporatave - S SH ISO 26000:2010”;
- “Të pasigurt nëse keni implementuar sistemin e duhur të sigurisë ushqimore? Një standard i ri mund t’Ju ndihmojë - S SH EN ISO 22000”;
- “Të rehat më të fundit në Fushën e Menaxhimit të Energjisë”.

Publikimin e **Aktiviteve dhe njoftimet për shtyp mbi**:

- Forumin e Drejtuesve të Organeve Kombëtare (CEO) të Standardizimit;
- Eurocodet;
- Samitin e 3-të Evropian të Standardizimit;
- Standardizimi dhe Bizneset e Vogla dhe të Mesme (SMEs);
- Pjesëmarrjen në Panairin “Gur mbi Gur”;
- Ditën Botërore të Standardeve;
- Pjesëmarrjen në Mega Panairin e Fundvitit.

Publikimin në faqe të **Buletinëve të Standardeve**:

- Buletini Nr. 57 Tetor – Dhjetor 2013
- Buletini Nr. 58 Janar – Mars 2014
- Buletini Nr. 59 Prill – Qershor 2014
- Buletini Nr. 60 Korrik – Shtator 2014

Janë publikuar gjithashtu **Programi i Punës dhe Notifikimet**

- Programi i Punës, Janar-Qershor 2014;
- Programi i Punës, Korrik-Dhjetor 2014;
- Notifikimet në kuadër të OBT dhe CEFTA.

Është hapur rubrika e re **“Dialog me palët e interesuara”** - Informacion në lidhje me punën e Komiteteve Teknike të DPS-së;

dhe janë publikuar e rifreskuar me informacion **Rubrikat**:

- **“Standardi Shqiptar (S SH) më i ri”**  
Standardet e adoptuara së fundmi nga Komitetet Teknike të DPS.

- **“Këndi i standardeve”**

Përzgjedhje dhe evidentim i standardeve më të përdorshme nga biznesi dhe ekonomia (seritë mbi menaxhimin e sistemeve ushqimore, ambientale, energjisë, cilësisë, informacionit etj).

Është publikuar dhe shpërndarë fletëpalosja “**Komitetet Teknike (KT) dhe adoptimi i standardeve për Korrik-Dhjetor 2014**”.

Në faqen e internetit të DPS-së jepen procedurat për kërkimin dhe gjetjen e Standardeve Shqiptare. Faqja përmban të gjithë buletinët informativë dhe Katalogun e Standardeve Shqiptare 2014, si dhe guidën për përdorimin e saj.

Janë përgatitur dhe publikuar në faqen e internetit njoftimet mbi **Aktivitetin e strukturave** të DPS-së:

- Mbledhjet e Bordit Drejtues (**21** Mars 2014 dhe **20** Qershor 2014);
- Mbledhjet e Bordit Teknik (**07** Shkurt 2014 dhe **04** Korrik 2014)

Janë promovuar dhe është bërë marketing me standardet e reja dhe jo vetëm, të evidentuara si standarde tepër të rëndësishme, që kanë të bëjnë me sigurinë e jetës dhe shëndetit të njerëzve, duke përdorur të gjitha mjetet e komunikimit në dispozicion si e-mail, *ëbsite*, media sociale, etj.

### **Publikimet dhe Shpërndarja e tyre**

Të gjitha standardet puro shqiptare në fuqi, ato të adoptuara si dhe standardet e shfuqizuara gjatë një viti gjenden në Katalogu i Standardeve Shqiptare, që publikohet çdo vit. Katalogu i Standardeve Shqiptare 2014 është në format letër dhe elektronik me CD.

Gjatë 2014 janë shpërndarë Katalogu i Standardeve Shqiptare 2014 dhe botime të tjera (postera, fletëpalosje, broshura etj), ku veçojmë:

- **505** – Katalogë të Standardeve Shqiptare 2014 (**265** në format letër dhe **240** me CD);
- **92** – Sistemet e Menaxhimit Mjedisor për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme;
- **85** – Krijimi i përfitimeve - Standardizimi për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme;
- **54** – Përfitimet nga standardet;
- **70** - Udhëzuesi i Menaxhimit të Shërbimeve;
- **65** - Direktivat dhe standardet që lidhen me to;
- **60** - Standardizimi, një garanci më shumë për cilësinë dhe sigurinë e produkteve;
- **240** – Buletinë informative (të shpërndarë elektronikisht).

### **Mediat Sociale**

Janë hapur profile të DPS-së në **Mediat Sociale** (Linkedin, Google+, Facebook, Youtube) me qëllim informimin masiv, duke pasqyruar aktivitetet kryesore të DPS-së dhe ndjekjen e aktivitetit të standardizimit në nivel Evropian dhe Ndërkombëtar përmes profileve të tyre.

Përmes Profileve të DPS në Mediat Sociale ([DPS Facebook](#), [DPS Google+](#), [DPS Linkedin](#)) është pasqyruar aktiviteti i DPS-së (të reja, mbledhje, artikuj, standarde të reja etj) si dhe është ndjekur aktiviteti i ministrive, institucioneve, bizneseve vendase, organizmave ndërkombëtare të standardizimit (CEN, CENELEC, ISO, IEC, ETSI, ITU etj) dhe trupave kombëtare të standardizimit (AENOR, AFNOR, BSI, DIN etj).

Numri i “ndjekësve” të DPS-së përmes këtyre profileve për vitin 2014 është:

- DPS Facebook numëron **425**;
- DPS Google+ numëron **2632** shikime;

aktualisht rezultojnë mesatarisht **96** vizita për çdo postim, në secilin prej profileve.

Pasqyrimi i **Ditës Botërore të Standardeve** ka qënë një ndër aktivitetet më të ndjekura me rreth **638** shikime, për postimet në Profilet e DPS-së në mediat sociale.

## Marrja e feedback-ut

Marrja e *feedback-ut* nga klienti përmes realizohet përmes faqes së internetit në formë sondazhi (rubrika sondazh në faqen kryesore) dhe plotësimit të formularëve (pyetje mbi cilësinë, shpejtësinë, kompetencën e punonjësve, mënyrën e pagesës etj në kryerjen e shërbimeve që DPS ofron) si dhe nga klientët që blejnë standarde në zyrat tona. Në muajin nëntor është realizuar “*Analiza e feedback-ut*”, vlerësimet mbi përgjigjet e dhëna janë publikuar në faqen e internetit.

## Shërbimi ndaj klientëve


Gjatë 2014 janë ri-shtypur dhe formatuar 70 standarde puro kombëtare (SSH) kryesisht të fushave: Materiale ndërtimi, industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të mineraleve të ngurta, produkteve të drurit, fibrës dhe letrës.

## Shitja e standardeve

Gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2014 janë shitur gjithsej:

- **2120** standarde nga të cilat **1857** st. janë standarde Europiane, përkundrajt
- **1864** st. në total nga të cilat **1733** standarde janë st. Europiane të shitura gjatë 2013.

Grafiku i mëposhtëm jep situatën e shitjeve për vitin 2014 krahasuar me vitin 2013:



Siç shihet edhe nga grafiku dhe nga tabela me të dhënat e mësipërme për vitin 2014 ka rritje si në numrin total të standardeve ashtu edhe për standarde europiane.

## Notifikimet

Lidhur me detyrimet që kemi si Pikë Referimi e OBT dhe CEFTA, gjatë këtij viti janë qarkulluar rregullisht të gjitha notifikimet e marra nga vendet anëtare të OBT, në të gjithë ministritë dhe institucionet shtetërore, sipas përkatësisë.

Janë kryer notifikimet e programeve të punës 6 mujore të standardeve në Qendrën e Përbashkët të Informacionit të ISO/IEC.

Është kryer përgatitja e njoftimeve dhe notifikimi në CEN dhe CENELEC për standardet e reja kombëtare (adoptimin e standardeve EN si SSH) nëpërmjet *iPROJEX*-it, në zbatim të procedurave të punës.

## Objektivat për 2015

- Ndjekja e miratimit të projektakteve ligjore e nënligjore në fushën e standardizimit;
- Hartimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave për bazën e të dhënave të DPS;
- Progres në miratimin e EN-ve si S SH;
- Përdorimi dhe mirëmbajtja e Sistemit (database) të Menaxhimit të Standardeve;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i rregulloreve dhe procedurave të punës sic kërkohen nga Guida 20 e CEN & CENELEC;
- Rritje e ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë vendas mbi rolin e DPS-së në tregun e lirë dhe mbi rëndësinë e përdorimit të standardeve Europiane në produktet dhe shërbimet e tyre me synim rritjen e shitjeve të standardeve;
- Rritja e ndërgjegjësimit në lidhje me pjesëmarrjen e palëve të interesuara në procesin e standardizimit;
- Sigurimi në vijim i transparencës dhe informimit të publikut të gjerë nëpërmjet publikimeve të DPS-së (Buletinët, Katalogut të Standardeve Shqiptare dhe informimeve dhe njoftimeve të tjera të kësaj natyre);
- Forcimi i kapaciteteve të DPS nëpërmjet trajnimeve të stafit.